



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
V E N D I M
K.P.P. 452/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.10.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Fedos” shpk, si dhe anulimin e procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-67884-08-06-2020, me objekt “Blerje Materiale Respiratore dhe Monitori për Reanimacionin pranë SUT – Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku te gjitha kushtet janë te përcaktuara për një periudhë 12 mujore”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës 8,066,067 (tetë milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

Ankimues:

“Montal” shpk
Adresa: Rruga “Dervish Hima”, 3 Kullat, K. 3, Sh. 1,
Ap. 9/2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Universitar i Traumës
Adresa: Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.08.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-67884-08-06-2020, me objekt “*Blerje Materiale Respiratore dhe Monitori për Reanimacionin pranë SUT – Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te përcaktuara për një periudhë 12 mujore*”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës 8,066,067 (tetë milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.

II.2. Në datën 31.08.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 03.09.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Fedos” shpk	7,082,100 lekë	kualifikuar
2. “Montal” shpk	7,962,400 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 03.09.2020, operatori ekonomik “Montal” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4.1. Në datën 09.09.2020, operatori ekonomik “Montal” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Fedos” shpk në këtë procedurë prokurimi në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Montal AL shpk mori pjese ne kete procedure prokurimi te zhvilluar me date 31.08.2020, nga Spitali Universitar i Traumes Tirane.

Ne date 03.09.2020 jemi njohur me rezultatet e vleresimit te kesaj procedure prokurimi te publikuara nga Autoriteti Kontraktor ne Sistemin Elektronik te Prokurimit si meposhte:

1. “Fedos” shpk	7,082,100 lekë	kualifikuar
2. “Montal” shpk	7,962,400 lekë	kualifikuar

Se pari, evidentojme faktin qe ne date 27.08.2020, ora 15.05, ne Sistemin Elektronik te Prokurimit eshte pezulluar kjo procedure prokurimi dhe jane shpallur ndryshimet meposhte po te njejten date ne oren 15:08.

ISHTE:

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

5. Ofertuesi te paraqese Certificate konformiteti CE per materialet e ofertuara.

Shtojca 10 SPECIFIKIMET TEKNIKE

- Të gjitha materialet/mallrat e konsumit për pajisjet e Reanimacionit në SUT duhet të jenë sipas standarteve CE.
- Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e levrimit të mallit.

BËHET:

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

5. Ofertuesi te paraqese Certificate konformiteti CE ose FDA, dhe ose Ekuivalent per materialet e ofertuara

Shtojca 10 SPECIFIKIMET TEKNIKE

- Të gjitha materialet/mallrat e konsumit për pajisjet e Reanimacionit në SUT duhet të jenë sipas standarteve CE /FDA/ Ekuivalent.*
- Ato duhet të jenë të markuara CE/FDA/Ekuivalent në momentin e levrimit të mallit*

Sa mesiper, Autoriteti Kontraktor ka kryer ndryshime thelbesore ne Kushtet e Vecanta te DST ne lidhje me kapacitetin teknik te operatoreve ekonomike dhe me specifikimet teknike duke mos publikuar asnje shtyrje te afatit te dorezimit te ofertave, ne kundershtrim me Ligjin e Prokurimit Publik, Neni 42 - Sqarimet dhe ndryshimi ne dokumentet e tenderit, Pika 2 dhe Pika 2/1 ku cilesohet: “Autoriteti kontraktor, ne cdo kohe, perpara mbaritnit te afatit te fundit per dorezimin e ofertave dhe per cfaredolloj arsyeje, me nismen e vet ose me kerkese per sqarim nga nje operator ekonomik, mund te beje ndryshime ne dokumentet e tenderit, permes hartimit te nje shtojce. Cdo shtojce u komunikohet menjehere te gjithë operatoreve ekonomike, qe kane terhequr dokumentet e tenderit dhe behet detyruese per ta. Shtojca vihet ne dispozicion edhe ne rruge elektronike. Ne cdo rast kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor per dorzimin e ofertes me 5 dite, ndersa per prokurimet mbi kufijte e larte monetare me 10 dite.

Zgjatja e afatit kohor per dorezimin e ofertes me 5 dites, sic percaktohet nga Neni 42, Pika 2/1 nuk eshte kryer, duke shkelur Ligjin e Prokurimit Publik dhe duke e bere kete procedure prokurimi te pa vlefshme. Mungesa e shtyrjes se afatit te dorezimit te ofertave na ka pamundesuar padrejtesisht pergatitjen e nje oferte akoma me konkurruese. Per kete arsye kerkojme qe kjo procedure te anullohet.

Se dyti, evidentojme faktin qe operatori ekonomik “Fedos” shpk pjesemarres ne kete procedure prokurimi nuk ka ofruar nje sere produktesh ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara ne DST. Konkretisht, kemi informacion qe produktet e listuara meposhte, te ofruara na operatori ekonomik “Fedos” shpk nuk jane kompatibel me pajisjet mjekesore te instaluara ne Spitalin Universitar te Traumes.

Nr.	Pershkrimi	Detaje Teknike
2	Watertrap per modul CO2 per modul carescape B450	Produkti i Ofruar nga FEDOS Sh.p.k. nuk deshmon nepermjet katalogeve dhe certifikatave CE qe eshte kompatibel me modul CO2 per modul CO2 carescape B450. Kur produkti i ofruar nuk eshte kompatibel atehere rezulton ne matje te gabuar te CO2 tek pacienti dhe potencialisht ne humbje te jetes pervec demtimit te pajisjes. Per kete arsye kerkojme qe te behet verifikimi praktik i funksionimit te produktit te ofruar nga FEDOS sh.p.k. nepermjet paraqitjes se nje mostre.
4	Qark respiratori per Femije dual limb heated with water chamber per lageshtuesit Hamilton H900 dhe respirator GI carescape R860	Kataloget e ketyre produkteve mund te gjenden lehtesisht ne internet dhe per kete arsye i kerkojme Autoritetit Kontraktor te kryeje verifikimin ne website-in e trupit certifikues certipedia.com vlefshmerine e certifikatave CE te dorezuara nga FEDOS sh.p.k.
5	Qark respiratori Per adult dual limb heated with water chamber per lageshtuesit Hamilton H900 dhe respirator GI carescape R860	
6	Parafiltri adaptimi per respirator GI carescape R860	Parafiltri antimikrobal per respiroret e avancuar GE R860 prodhohet vetem nga fabrika te autorizuar nga GE dhe nga vete GE. Evidentojme faktin qe ky produkt ka nje rendesi te vecante per te garantuar mos infektimin e pacientit nga patogjenet dhe garanton njekohesisht rezistence minimale ne fluksin respirator. Nga informacioni qe ne kemi, produkti i ofruar nga FEDOS sh.p.k. nuk eshte kompatibel me pajisjen R860 dhe paraqet rrezik per pacientin dhe per demtimin e respiratoreve te avancuar dhe te kushtueshem te instaluar ne Spitalin e Traumes. Per kete arsye kerkojme qe te behet verifikimi praktik i funksionimit te produktit te ofruar nga FEDOS sh.p.k. nepermjet paraqitjes se nje mostre.
7	Saturometer adult per monitore carescape B450	GE perdor teknologji te dedikuar te monitorimit te saturometrisë ne monitoret e pacientit. Nga informacioni qe kemi, produktet e ofruara nga FEDOS sh.p.k. per artikujt Nr.7 dhe Nr.8 nuk jane kompatibel me teknologjine e monitoreve te pacientit Carescape B450 qe disponon spitali. Per kete arsye kerkojme qe te behet verifikimi praktik i funksionimit te produkteve te ofruara nga FEDOS sh.p.k. nepermjet paraqitjes se nje mostre.
8	Saturometer femije per monitore carescape B450	
10	Manshete presioni arterial adult per monitor carescape B450	Nga informacioni qe disponojme, produktet e ofruara nga FEDOS sh.p.k. per Artikujt Nr.10 dhe 11 nuk jane kompatibel me monitret e pacientit Carescape B450. Per kete arsye kerkojme qe te behet verifikimi praktik i funksionimit te produkteve te ofruara nga FEDOS sh.p.k. nepermjet paraqitjes se nje mostre Adult dhe nje mostre Pediatrike.
11	Manshete presioni arterial pediatrik per monitor carescape B450	
13	Sensor monitorimi temperature per lekuren	Nga informacioni qe kemi, FEDOS sh.p.k. nuk ka ofruar nje produkt kompatibel me pajisjet qe disponon spitali. Per kete arsye kerkojme qe te behet verifikimi praktik i funksionimit te produktit te ofruar nga FEDOS sh.p.k. nepermjet paraqitjes se nje mostre.
14	Kabell SpO2 per lichen e sensoreve te saturometrisë me monitoret e pacientit	Kabelli SpO2 i ofruar nga FEDOS sh.p.k. nuk eshte kompatibel me produktet e kerkuara ne artikujt Nr. 7 dhe Nr.8. Per kete arsye kerkojme qe te behet verifikimi praktik i funksionimit te produkteve te ofruara nga FEDOS sh.p.k. nepermjet paraqitjes se nje mostre.

15	Kabelli EKG per lidhjen e monitorit te pacientit me setin e konektoreve te EKG	Kabelli EKG i ofruar nga FEDOS sh.p.k. nuk eshte kompatibel me pajisjet qe disponon spitali. Per kete arsye kerkojme qe te behet verifikimi praktik i funksionimit te produkteve te ofruara nga FEDOS sh.p.k. nepermjet paraqitjes se nje mostre.
16	Set Konektoresh per EKG te monitotreve me 3 lidhje	Konektoret EKG me 3 dhe 5 lidhje te ofruar nga FEDOS sh.p.k. nuk jane kompatibel me pajisjet qe disponon spitali dhe me Artikulin Nr. 15. Per kete arsye kerkojme qe te behet verifikimi praktik i funksionimit te produkteve te ofruara nga FEDOS sh.p.k. nepermjet paraqitjes se nje mostre.
17	Set konektoresh per EKG te monitoret me 5 lidhje	
18	Tub koneksioni per manshetat e tension	Tubi liches per manshetat e presionit jo-invaziv qe eshte ofruar nga FEDOS sh.p.k. nuk eshte kompatibel me pajisjet qe disponon spitali dhe ne vecanti me artikujt Nr.10 dhe 11.
25	Sensore Fluksi per aparatet e anestezise GE	Produkti i Ofruar nga FEDOS Sh.p.k. nuk deshmon nepermjet katalogeve dhe certifikateve CE qe eshte kompatibel me pajisjet e anestezise GE Aespire te instaluara ne kete spital. Produkti i ofruar jo vetem qe nuk eshte kompatibel por paraqet rrezikshmeri per jeten e pacienteve duke qene i lidhur drejtperdrejt me sasine dhe saktesine e fluksit respirator qe shkon ne rruget e frymemarrjes. Ofrimi i nje produkti jo-kompatibel eshte papergjegjshmeri e ofertesit dhe personave pergjegjes per pranimin e nje oferte te tille. Ju kujtojme qe ky artikulli ka te beje drejtperdrejt me jeten e pacienteve dhe i ngarkon padrejtesisht me pergjegjesi mjeket te cilet i perdorin pajisjet. Per kete arsye kerkojme qe te behet verifikimi praktik i funksionimit te produktit te ofruar nga FEDOS sh.p.k. nepermjet paraqitjes se dy mostrave te sensoreve te fluksit (Inspirim+ekspirim).
26	Sensore O2 per aparatet e anestezise GE	Sensoret O2 te ofruar nga FEDOS sh.p.k. nuk jane kompatibel me pajisjet e anestezise GE Aespire. Rrjedhimisht, kerkojme qe nga ana e autoritetit kontraktor te behet verifikimi i produktit te ofruar nga FEDOS sh.p.k. nepermjet mostrave te perputheshmerise fizike dhe funksionale te ketij artikulli. Ju evidentojme qe matja e gabuar e FiO2 gjate anestezise mund te rezultojte fatale per pacientin.

Ne konkluzion, jemi te bindur qe te gjithë produktet e listuar mesiper te ofruar nga “Fedos” shpk nuk jane kompatibel me pajisjet e instaluara ne kete spital. Mosperputhja e produkteve te ofruara nga “Fedos” shpk e ben oferten e ketij operatori ekonomik te papergjegjshme dhe te rrezikshme per jeten e pacienteve. Rrjedhimisht kerkojme qe oferta e “Fedos” shpk te skualifikohet.

Evidentojme nder te tjera qe investimi me pajisje mjekesore i kryer ne Spitalin Universitar te Traumes ne vitin 2017 eshte nje model kombetar i cilesise se sherbimit te reanimacionit dhe sallave operate. Per te mbrojtur kete investim dhe per te garantuar cilesine maksimale te sherbimit te ofruar ndaj pacienteve ne kete procedure prokurimi duhet te kerkohen garanci per kompatibilitetin e produkteve te ofruara nepermjet kerkeses se Autorizimit te Prodhuesit dhe mostrave te artikujve me kritike te lidhur drejtperdrejt me jeten e pacientit.

Duke ju falenderuar, besojme ne vleresimin objektiv te ankeses tone.

II.4.2. Me shkresën Nr. 1758/1 prot, datë 15.09.2020 autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Montal” shpk ku ka vendosur refuzimin e ankesës së bërë prej tij pranë autoritetit kontraktor.

II.4.3. Në datën 23.09.2020 operatori ekonomik ankimues “Montal” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 1931/1 prot., datë 05.10.2020, protokolluar me tonën me numër 1168/2 prot., datë 08.10.2020, me objekt “*Informacion*” është depozituar pranë Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “*Montal*” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “*Fedos*” shpk me arsyetimin se: “*evidentojme faktin qe operatori ekonomik “Fedos” shpk pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk ka ofruar një sërë produktesh në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST. Konkretisht, kemi informacion që produktet e listuara mëposhtë, të ofruara na operatori ekonomik “Fedos” shpk nuk janë kompatibel me pajisjet mjekësore të instaluar në Spitalin Universitar të Traumës. Në konkluzion, jemi të bindur që të gjithë produktet e listuar mësipër të ofruar nga “Fedos” shpk nuk janë kompatibël me pajisjet e instaluar në këtë spital. Mospërputhja e produkteve të ofruara nga “Fedos” shpk e bën ofertën e këtij operatori ekonomik të papërgjegjshme dhe të rrezikshme për jetën e pacientëve. Rrjedhimisht kërkojmë që oferta e “Fedos” shpk të skualifikohet*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.7 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Pjesët duhet të jenë një prodhim original/ekuivalent (të vërtetohet me foto dhe Katalogë për të gjithë artikujt e ofruar. OE duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rëndor të percaktuar në formularin e ofertës. Katalogët do të pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.*

III.1.2. Në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njesia	Specifikime	Sasia
1	Set sensor nje perdorimesh per monitorizimin e presionit invaziv	cope		100
2	Ëatertrap per modul CO2 per modul	cope		50

	carescape B450			
3	Tub I holle per end T CO2 <per ëatertrap.	cope		400
4	Qark respiratori per Femije dual limb heated ëith ëater chamber per lageshtuesit Hamilton H900 dhe respirator GI carescape R860	cope		2
5	Qark respiratori Per adult dual limb heated ëith ëater chamber per lageshtuesit Hamilton H900 dhe respirator GI carescape R860	cope		30
6	Parafilter adaptimi per respirator GI carescape R860	cope		250
7	Saturometer adult per monitore carescape B450	cope		18
8	Saturometer femije per monitore carescape B450	cope		4
9	Saturometer portabel per matjen e saturimit ne gisht	cope		35
10	Manshete presioni arterial adult per monitor carescape B450	cope		25
11	Manshete presioni arterial pediatrik per monitor carescape B450	cope		2
12	Manshete presioni aksesor per presionin invaziv	cope		5
13	Sensor monitorimi temperature per lekuren	cope		20
14	Kabell SpO2 per lichen e sensor eve te saturometrise me monitoret e pacientit	cope	Kabell lidhes monitor -sensor per sensoret e saturimit te monitoret carescape GE	25

15	Kabell EKG per lidhjen e monitorit te pacientit me setin e konektoreve te EKG	cope	Kabell koneksioni per EKG per monitor carescape GE	30
16	Set Konektoresh per EKG te monitortre me 3 lidhje	cope	Kabell koneksioni per EKG per monitor carescape GE	24
17	Set konektoresh per EKG te monitored me 5 lidhje	cope	Kabell koneksioni per EKG per monitor carescape GE	25
18	Tub koneksioni per manshetat e tension	cope	Tub koneksioni per manshetat e tension per monitore carescape GE	30
19	Sistem Aspirimi per qark te mbyllur	cope	Set kateter aspirimi i mbyllur me mbulese ,madhesi 10-16 fr me valvol aspirimi me mekanizem sigurie ,nyje lidhese per pershtatjen me qarkun e respiratorit me tubin e intubimit dhe kanjulen e trakeostomise ,porte shpelarje ,e paisur me Markus gjatesie dhe valvol izolimi prdorim per minimum 48 ore	800
20	Sistem reanimimi dhe induksioni pediatrik	cope	I paisur me balon 0.5-1 L valvol sigurie pediatrike konektor me berryl,porte monitorizimi CO2 dhe tub 1.8-2 m	25
21	Sistem reanimimi dhe induksioni Adult	cope	I paisur me balon 2 L ,valvol sigurie ,conector me berryl dhe tub 1,8-2 m	25
22	Maske laringeale per urgjenca Nr 1,5-5	cope	Maske me balon pa fryrje per intubim te shpejte che me kanal gastrik ne dalje fundore	50
23	Maske kapnografie	cope	Maske me zgjatues 1,5-2m me linje monitorizimi CO 2 te integruar	20
24	Tracheotomy	cope	I pershtatshem per terapi me O2 i paisur me mekanizem sigurie kunder bllokimeve	250
25	Sensore Fluksi per aparatet e anestezise GE	cope		12
26	Sensore O2 per aparatet e anestezise GE	cope	Sensore O2 per aparatet e anestezise GE me kohezgjatje 1	12

			vjecare	
27	AMBU	cope	Per ventilim manual te pacientit	30
28	Maska CPAP	cope	Maske per ventilier mekanik joinvaziv me numra te ndryshem te pershtatur me respiratorer GI	30

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Fedos” shpk në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve Teknike.*
- *Deklaratë garancie.*
- *Deklarata Konformiteti për produktet objekt prokurimi.*
- *Katalogët Teknikë nga prodhuesit e mallrave objekt prokurimi.*

III.1.4. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

III.1.5. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*”.

III.1.6. Në nenin 46, të LPP-së parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*. b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*”

III.1.7. Në nenin 53, pika 3 të LPP-së parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.8. Në nenin 27, *“Kontratat e mallrave”* pika 3 e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”*.

III.1.9. Në nenin 27 *“Kontratat e Mallrave”*, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* parashikohet shprehimisht: *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*
- c) *c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.10. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret për

kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.11. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku operatorët ekonomik duhet të markojnë në katalogët përkatës produktet që ofertojnë sipas specifikimeve teknike të kërkuara për secilin artikull. Ndërsa në specifikimet teknike të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se për artikullin me nr rendor **14- Kabëll SpO2 për lichen e sensorëve të satuometrisë me monitorët e pacienti; 15- Kabëll EKG për lidhjen e monitorit të pacientit me setin e konektorëve të EKG; 16- Set Konektorësh për EKG të monitortëve me 3 lidhje; 17- Set konektorësh për EKG të monitored me 5 lidhje; 18- Tub koneksioni për manshetat e tension; 26- Sensorë O2 për aparatet e anesteziës;** nga ana e autoriteti kontraktor rezulton të jetë përcaktuar specifikimi teknik për artikullin **14- Kabell lidhes monitor -sensor per sensoret e saturimit te monitoret carescape GE; 15- Kabell koneksioni per EKG per monitor carescape GE; 16- Kabell koneksioni per EKG per monitor carescape GE; 17- Kabell koneksioni per EKG per monitor carescape GE; 18- Tub koneksioni per manshetat e tension per monitore carescape GE; 26- Sensore O2 per aparatet e anesteziise GE me kohezgjatje 1 vjecare,** artikuj këto për të cilat është janë ngritur pretendime edhe operatori ekonomik ankimues, ndërsa lidhur me artikujt e tjerë që operatori ekonomik ankimues ka ngritur pretendimi nga ana e autoriteti kontraktor në shtojcën 10 “*Specifikimet Teknike*” nuk janë parashikuar specifikime teknike, por thjeshtë emërtesa e artikujve që nevojiten në këtë procedurë. KPP, nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Fedos” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipërcituar përse i përketë specifikimeve teknike për artikujt e mësipërm për të cilën operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk janë përmbushur nga operatori ekonomik “Fedos”, KPP konstaton se dokumentacioni katalogë teknike dëshmon qartë se artikujt e mësipërcituar evidentohen në katalog dhe janë në përputhje specifikimet teknike që ka parashikuar dhe autoriteti kontraktor në shtojcën 10 “*Specifikime teknike*”, nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk ka mospërputhje midis specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në katalogët teknikë nga operatori ekonomik “Fedos” shpk, si përse i përketë artikujve për të cilat ngren pretendime operatori ekonomik ankimues ashtu edhe për artikujt e tjerë që parashikohen në shtojcë.

KPP gjykon se operatori ekonomik “Fedos” shpk me dokumentacionin e paraqitur dëshmon se plotëson specifikimet teknike për artikujt e mësipërcituar pasi në katalogët teknike të lëshuar nga prodhuesit përcaktohen qartë specifikimet teknike të parashikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit për artikujt objekt prokurimi. Në këtë kuptim

KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik “Fedos” shpk i renditur i pari nuk ka ofruar një sërë produktesh në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST, nuk qëndron në rastin konkret pasi në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori “Fedos” shpk shprehen qartë në katalogjet teknike specifikimet e artikujve në përputhje dhe sipas parashikimeve të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Fedos” shpk i plotëson specifikimet teknike në lidhje me produktet sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, duke dëshmuar se gëzon kapacitete për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Montal” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ngritura nga operatori ekonomik se: *“Autoriteti Kontraktor ka kryer ndryshime thelbësore në Kushtet e Vecanta të DST në lidhje me kapacitetin teknik të operatoreve ekonomike dhe me specifikimet teknike duke mos publikuar asnjë shtyrje të afatit të dorëzimit të ofertave, në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Neni 42 - Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit, Pika 2 dhe Pika 2/1 ku cilesohet: “Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfaredolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojce u komunikohet menjëherë të gjithë operatoreve ekonomike, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe behet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në çdo rast kur ndryshohen dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 dite, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetare me 10 dite. Zgjatja e afatit kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, siç përcaktohet nga Neni 42, Pika 2/1 nuk është kryer, duke shkelur Ligjin e Prokurimit Publik dhe duke e bërë këtë procedurë prokurimi të pa vlefshme. Mungesa e shtyrjes së afatit të dorëzimit të ofertave na ka pamundësuar padrejtesisht përgatitjen e një oferte akoma me konkurruese. Për këtë arsye kërkojmë që kjo procedurë të anulohet: Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.2.1. Në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, Shtojca 9, pika 2.3.5, “Kapaciteti teknik”, dhe shtojca 10 “Specifikimet teknike” është përcaktuar kriteri si më poshtë:

Ishte:

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

5. Ofertuesi të paraqesë Certificate konformiteti CE për materialet e ofertuara.

Shtojca 10 SPECIFIKIMET TEKNIKE

- Të gjitha materialet/mallrat e konsumit për pajisjet e Reanimacionit në SUT duhet të jenë sipas standarteve CE.*

- *Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e levrimit të mallit.*

III.2.2. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin elektronik të prokurimeve (SPE) më datë 27.08.2020, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Bëhet:

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

5. Ofertuesi te paraqese Certificate konformiteti CE ose FDA, dhe ose Ekuivalent per materialet e ofertuara

Shtojca 10 SPECIFIKIMET TEKNIKE

- *Të gjitha materialet/mallrat e konsumit për pajisjet e Reanimacionit në SUT duhet të jenë sipas standarteve CE /FDA/ Ekuivalent.*
- *Ato duhet të jenë të markuara CE/FDA/Ekuivalent në momentin e levrimit të mallit*

III.2.3. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë ankimi administrativ referuar formularit të ankesës, dokumentacionit shoqërues të saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor me shkresën nr. 1931/1 prot., datë 05.10.2020, protokolluar me tonën me numër 1168/2 prot., datë 08.10.2020, rezulton se ankesa e operatorit ekonomik “*Montal*” shpk është dorëzuar në protokollin e autoritetit kontraktor më datë 09.09.2020, fakt i cili pranohet dhe nga vetë ankimues.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në dy momente të veçantë të lex specialis Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar. Në rastin e ankesave kundër vendimeve të autoritetit kontraktor (referuar nenit 63 pika 2 të LPP-së) në të cilën parashikohet se “*Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktori paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji*” afati

procedural për paraqitjen e ankesës pranë këtij të fundit si shkallë e parë e ankimit nis nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni. Ndërkohë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, lex specialis ka parashikuar se *llogaritja e afateve të ankimit nis nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe se operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paraqesin ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe jo nga dita e nesërme e punës.* K.P.P. gjykon se vetë ligjvënësi ka ndarë dy momentet e mësipërme në lidhje me llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankimit administrative pranë autoritetit kontraktor, ku në rastin e ankimit për dokumentet e tenderit ka parashikuar se llogaritja e afateve nis nga dita e publikimit të njoftimit të kontratës ose shtojces për modifikimin e dokumentave standarte të tenderit në S.P.E. Referuar datës së publikimit të shtojcës në Sistemin e Prokurimeve Elektronike e cila mban datën 27.08.2020 dhe datës së dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor e cila mban datën 09.09.2020, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor, K.P.P. konstaton se ankesa e operatorit ekonomik “Montal” shpk pranë autoritetit kontraktor në lidhje kundërshtimin e shtojcës është paraqitur jashtë afatit 7 ditor pranë autoritetit kontraktor dhe ky i fundit nuk legjitimohet racione temporis. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimes, ka patur në dispozicion momentin procedural në lidhje me kundërshtimin e shtojcës “për shtyerjen e afatit me 5 ditë të dorëzimit të ofertave”, aq më tepër që operatori ekonomik ankimes është pjesëmarrës në këtë procedurë si dhe statusi i tij figuron i kualifikuar, ndaj në respekt të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se afatet e ankimit parashikuar nga neni 63 i LPP-së janë afate prekluzive. Këto afate, duke qenë afate prekluzive nuk mund të pezullohen, të ndërpriten apo të rivendosen. Për sa kohë që pala ankimese nuk ka respektuar afatet e ankimit për paraqitjen e ankesës në shkallën e parë të ankimit parashikuar nga lex specialis për arsyet e mësipërme e drejta e ankimit për to në një shkallë më të lartë ka rënë në dekadencë.

III.2.5. Ankimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar shkallët e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj dhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk merret në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Montal” shpk për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-67884-08-06-2020, me objekt “*Blerje Materiale Respiratore dhe Monitori për Reanimacionin pranë SUT – Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku te gjitha kushtet janë te përcaktuara për një periudhë 12 mujore*”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës 8,066,067 (tetë milion e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar i Traumës.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1168 Protokoli, Datë 23.09.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri